

Vendim nr. 156, datë 20.05.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

| | |
|-------------------|----------|
| Fiona Papajorgji, | Kryetare |
| Asim Vokshi, | Anëtar |
| Marjana Semini, | Anëtare |

në datën 20.05.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 8 (L) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **LINDITA SOKOLI (GODO)**, përfaqësuar nga avokati Virtyt Sokoli, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-4348, datë 22.10.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtuëshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); neni 1 i Protokollit nr. 1 të *KEDNJ*-së; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja është një ndër trashëgimtarët ligjorë të trashëgimlënësit Skënder Godo, tokat e të cilit, të ndodhura në afërsi të ish-kazermave ushtarake të qytetit të Delvinës dhe me sipërfaqe 7.000 m², janë shtetëzuar pa shpërblim me dekretligjin nr. 331, datë 15.05.1947 mbi shpronësimin e disa tokave dhe ndërtesave private në afërsitë e kazermave ushtarake të Delvinës (*dekretligji nr. 331/1947*).

2. Me vendimin nr. 31, datë 12.07.1994, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronës pranë Bashkisë Delvinë (*KKKP-ja, Delvinë*) ka trajtuar tokën e trashëgimlënësit Godo si pjesë të pronës së një familjeje tjetër, duke ua kthyer atë trashëgimtarëve të kësaj familjeje. Ky vendim është kundërshtuar në rrugë gjyqësore nga trashëgimlënësi, kërkesa e të cilit është pranuar pjesërisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Delvinë me vendimin nr. 475, datë 06.12.1995 (i saktësuar ky në vitin 1996 në lidhje me kufijtë e pronës), duke u detyruar KKKP-ja, Delvinë të konfirmojë pronën e tij prej 7.000 m². Në zbatim të vendimit të gjykatës, me vendimin nr. 294, datë 27.01.1997 (*vendimi nr. 294/1997*), KKKP-ja, Delvinë ka konfirmuar të drejtën e Skënder Godo për t'ua kompensuar në natyrë për sipërfaqen 7.000 m² “truall”.

3. Bazuar në parashikimet e ligjit nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” (*Ligji i Pronave*) e të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 223, datë 23.03.2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave” (*VKM-ja për Kompensimin e Pronave*), Agjencia e Trajtimit të Pronave (*ATP*) ka nisur procesin e vlerësimit financiar të këtij vendimi. Në kushtet e pamundësisë së përcaktimit të zërit kadastral të pronës, ATP-ja ka publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare fillimisht vlerën financiare të pronës “0” lekë, ndërsa më pas, me përditësimin e regjistrit të vendimeve të viteve 1993-2013, që u kanë njohur subjekteve të shpronësuara të drejtën e kompensimit, e ka vlerësuar atë financiarisht në vlerën 1.365.500 lekë. Për qëllime të përlllogaritjes së vlerës së pronës ATP-ja i është referuar hartës së Institutit të Gjeografisë dhe Infrastrukturës të vitit 1941, mbi bazën e së cilës ka vlerësuar se prona duhej trajtuar financiarisht si pjesërisht “truall” (500 m²) e pjesërisht “tokë bujqësore” (6.500 m²).

4. Bazuar në parashikimet e Ligjit të Pronave, kërkuesja ka kundërshtuar vlerësimin e ATP-së me kërkesëpadi në Gjykatën Administrative të Apelit, duke kërkuar detyrimin e këtij organi ta kompensojë për sipërfaqen 7.000 m² “truall” në vlerën 1.587 lekë/m², sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë” (*VKM nr. 89/2016*), në total në shumën 11.109.000 lekë, me argumentin se sipërfaqja e njohur për kompensim kishte qenë e gjitha “truall” dhe jo pjesërisht “tokë bujqësore” e pjesërisht “truall”, siç pretendonte ATP-ja.

5. Për qëllime të përcaktimit të zërit kadastral të pronës në kohën e shpronësimit, Gjykata Administrative e Apelit ka thirrur në gjykim ekspertin topogjeodet. Ky i fundit, duke u mbështetur në materialet e dosjes së vendimit nr. 294/1997 të KKKP-së, Delvinë, dokumentet e Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit para viteve 1990, dokumentet e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, si dhe në informacionin e paraqitur nga kërkuesja, ka arritur në përfundimin se prona ndodhej jashtë vijës së verdhë të qytetit të Delvinës të vitit 1965, ndërsa në raport me vijën kufizuese të këtij qyteti të vitit 1976, 3.411 m² të saj ndodheshin brenda vijës së verdhë, ndërsa 3.589 m² jashtë saj. Po sipas ekspertit, vërtetimi i Seksionit të Kadastrës, Delvinë i vitit 1995 i referohej “tokës bujqësore” të trajtuar nga Reforma Agrare, ndërkohë që, sipas fragmentit të hartës së vitit 1941, brenda konturit të pronës ndodhej një objekt ndërtimi me sipërfaqe rreth 300 m² (truall + banesë). Po ashtu, prona ndodhej në një distancë lineare prej 1.6 km nga zona më e afërt gjeografikisht, për të cilën vlera e “tokës bujqësore” ishte 88 lekë/m².

6. Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë gjykimit, me vendimin nr. 253 (86-2019-3602), datë 12.12.2019, Gjykata Administrative e Apelit ka rrëzuar kërkesëpadinë, me arsyetimin se vlerësimi i pronës ishte bërë nga ATP-ja në zbatim të drejtë të kuadrit ligjor për trajtimin e kompensimin e pronës, provave dokumentare dhe aktit të ekspertimit. Sipas saj, Ligji i Pronave parashikonte se prona e njohur për kompensim vlerësohej mbi bazën e zërit kadastral të pasurisë referuar gjendjes së saj në kohën e shpronësimit dhe, në kundërshtim nga sa kërkuesja pretendonte, dekretligji nr. 331/1947 nuk e kishte cilësuar pronën e saj si “truall”. Nga dokumentacioni arkivor rezultonte se kjo pronë kishte qenë pjesërisht “tokë bujqësore” dhe pjesërisht “truall”, çka ishte konfirmuar edhe nga ekspertiza teknike e të dhënat hartografike. Kundër këtij vendimi kërkuesja ka ushtruar rekurs.

7. Me vendimin nr. 00-2025-4348, datë 22.10.2025, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*), si dhe se ajo nuk ndodhej në kushtet e nenit 473/a të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*).

8. Në datën 27.03.2026 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkueses

9. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

9.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspekt të:

9.1.1. *Së drejtës së aksesit substancial* të lidhur me *standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje çështjes së përcaktimit të çastit të zhveshjes nga posedimi i pronës dhe gjendjes së pronës në atë moment, referuar zërave kadastralë të planeve të zhvillimit të zonës. Gjykata e Lartë ka bërë vlerësim sipërfaqësor të rekursit, pa arsyetuar për shkaqet e mospranimit të tij. Ajo nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve për cenimin nga gjykata e apelit të parimit të kontradiktoritetit në fazën e formimit të provës me ekspert, provë kjo e vetme e vendimtare në mbështetje të vendimit të saj, në drejtim të çështjeve që i duheshin nënshtruar ekspertimit.

9.1.2. *Parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi gjykata e apelit ka lejuar ndryshimin nga ATP-ja të cilësimit të pronës, duke tejkaluar në mënyrë flagrante kompetencën e saj të përcaktuar nga Ligji i Pronave.

9.2. *E drejta e pronës private*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, në lidhje me *parimin e sigurisë juridike* në drejtim të *pritsmërive të ligjshme*, pasi: i) Gjykata e apelit nuk ka marrë në konsideratë standardin minimal prej 10% të vlerës së pronës të përcaktuar me vendimin nr. 4, datë 15.02.2021 të Gjykatës, ndërsa Gjykata e Lartë nuk ka vlerësuar ndikimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor të procesit të kompensimit të pronave, si dhe jurisprudencën kushtetuese në përcaktimin e vlerësimit financiar të pronave. ii) Vendimi nr. 294/1997 i KKKP-së, Delvinë përbënte *res judicata* dhe i kishte krijuar pritshmëri të ligjshme për t'u kompensuar për pronën, sipas regjimit të saj “truall”, pritshmëri këto të cenuara në mënyrë abuzive nga ATP-ja, e cila ka ndryshuar regjimin juridik të pronës në pjesërisht “tokë bujqësore” e pjesërisht “truall”. Kjo shkelje nuk është riparuar as nga gjykatat e zakonshme, duke çuar në ulje të ndjeshme të vlerës financiare të saj. iii) Gjykata e apelit nuk ka marrë në konsideratë se shpronësimi i pronës ishte kryer për qëllime të ndërtimit të stadiumit të qytetit, çka do të thotë se regjimi juridik i saj ka qenë “truall”.

9.3. *Parimi i barazisë përpara ligjit*, i garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi në vendimin nr. 00-2021-230, datë 22.02.2021 për çështje të ngjashme, Gjykata e Lartë ka mbajtur tjetër qëndrim, duke vlerësuar se ish-Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme bënte vetëm regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe evidentonte statusin juridik e destinacionin e përdorimit të tyre, sipas

përcaktimeve të bëra nga organet kompetente, por nuk kishte kompetencë për përcaktimin e regjimit juridik të tokës.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkueses

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhen me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative. Në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitimit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuenin. Në këtë drejtim, Kolegji evidenton se mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

12. Në kuptim të sa më sipër, në vlerësim paraprak të respektimit të kriterëve të legjitimitimit për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues, Kolegji evidenton se ndonëse objekt i ankimit kushtetues individual është vetëm vendimi i Gjykatës së Lartë, në thelb, kërkuësja ka ngritur pretendime edhe për vendimin e gjykatës së apelit.

13. Në ankimin kushtetues individual kërkuësja ka pretenduar se vendimi i gjykatës së apelit i ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në aspekt të *së drejtës së aksesit*

substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, duke parashtruar si shkak, ndër të tjera, se Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të saj për cenimin nga gjykata e apelit të parimit të kontradiktoritetit në fazën e formimit të provës me ekspert. Për sa i takon këtij pretendimi, Kolegji vëren se nga materialet e depozituara me ankimin kushtetues individual nuk rezulton që në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë kërkuesja të ketë parashtruar problematika lidhur me marrjen e provës me ekspert gjatë gjykimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit. Për më tepër, Kolegji konstaton se shqyrtimi i çështjes është zhvilluar nga kjo e fundit në seancë plenare, në prani të mbrojtësit të zgjedhur nga kërkuesja, të cilit, gjatë gjykimit, i është garantuar mundësia për t'i drejtuar pyetje ekspertit dhe për të paraqitur qëndrimin e tij lidhur me gjetjet e aktit të ekspertimit (*shih procesverbalin e seancës së datës 10.12.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit, si dhe faqen 4, paragrafi i fundit, të vendimit të kësaj gjykate*). Për sa më sipër, në mungesë të parashtrimit në rekurs të pretendimit për cenimin e parimit të kontradiktoritetit, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkueses se Gjykata e Lartë nuk ka dhënë përgjigje për të nuk mund të merret në shqyrtim.

14. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, kërkuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor (në aspekt të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor dhe parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj), së drejtës së pronës (në aspekt të parimit të sigurisë juridike në drejtim të pritshmërive të ligjshme dhe parimit *res judicata*), si dhe parimit të barazisë përpara ligjit, të garantuara respektivisht nga nenet 42, 41, 4 dhe 18 të Kushtetutës.

15. Kërkuesja ka pretenduar cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit, duke parashtruar si shkak qëndrimin e ndryshëm të mbajtur nga Gjykata e Lartë në vendimin nr. 00-2021-230, datë 22.02.2021 të saj lidhur me veprimet që mund të kryenin ish-ZVRPP-të.

16. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se barazia përpara ligjit, e sanksionuar në nenin 18 të Kushtetutës, nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (*shih vendimet nr. 5, datë 13.02.2024; nr. 70, datë 27.12.2023; nr. 71, datë 27.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, Kolegji vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë, të cilit kërkuesja i referohet, ka pasur si objekt kundërshtimin e masës së shpërblimit të pronës në kuadër të një procedure shpronësimi për interes publik, për shkak se ZVRPP-ja nuk kishte pasqyruar ndryshimin e regjimit juridik të pronës, e cila, duke qenë e përfshirë brenda

vijës së verdhë të qytetit, nuk gëzonte më statusin e “tokës bujqësore”. Ndërsa , në rastin konkret, çështja e kërkueses ka të bëjë me përcaktimin e vlerës financiare të pronës, sipas kriterëve dhe mekanizmave të parashikuar nga legjislacioni i posaçëm për trajtimin e pronës, dhe jo me regjistrimin e pasaktë nga ATP-ja. Në këtë situatë, duke qenë se dy çështjet paraqesin karakteristika tërësisht të ndryshme juridike, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkueses për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit janë haptazi të pabazuara.

18. Për sa u përket pretendimeve të tjera, duke pasur parasysh se argumentet mbi të cilat kërkuësja bazon pretendimin për cenimin e së drejtës së pronës janë të ndërrarura me ato për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, Kolegji çmon ta trajtojë çështjen në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona private nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës private, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Po kështu, duke mbajtur në konsideratë se shkak i cenimit të së drejtës kushtetuese të pronës lidhet me mosmarrjen parasysh nga gjykatat të pretendimeve të kërkueses për regjimin juridik të pronës në çastin e shpronësimit, çka, sipas saj, ka ndikuar edhe në vlerësimin financiar të pronës nga ATP-ja, Kolegji do ta analizojë çështjen në vijim në drejtim të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

19. Për sa më lart, pretendimet e kërkueses do të analizohen në vijim në drejtim të *së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor dhe të drejtën e pronës.*

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor dhe të drejtën e pronës

20. Kërkuësja ka pretenduar se gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje çështjes së përcaktimit të gjendjes së pronës në momentin e zhveshjes nga posedimi, referuar zërave kadastralë të planeve të zhvillimit të zonës. Po sipas saj, gjykata e apelit nuk ka marrë në konsideratë se shpronësimi i pronës ishte kryer për qëllime të ndërtimit të stadiumit të qytetit, çka do të thotë se në momentin e shpronësimit regjimi juridik i pronës ka qenë “truall”, ndërsa Gjykata e Lartë e ka mbështetur vendimmarrjen e saj në një vlerësim sipërfaqësor të rekursit, pa arsytuar për shkaqet e mospranimit të tij. Vendimi nr. 294/1997 i KKKP-së, Delvinë i kishte krijuar pritshmëri të ligjshme për t’u kompensuar për pronën, sipas regjimit të saj “truall”, pritshmëri këto të cenuara në mënyrë abuzive nga ATP-ja, në drejtim të vlerësimit financiar të saj. Kjo shkelje nuk është riparuar as nga gjykatat e zakonshme.

21. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës parashikon se të drejtat kushtetuese dhe ligjore nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, përfshirë të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 10, datë 12.04.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo e drejtë nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për çështjen, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. E drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pranuar se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe se arsyetimi i kufizuar i vendimeve të mospranimit të rekursit nga Gjykata e Lartë nuk cenon standardin kushtetues të arsyetimit, përderisa në thelb shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Po sipas Gjykatës, ndërsa detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm është të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit që ato zhvillojnë, detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Në këtë drejtim, ajo nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 59, datë 16.10.2025; nr. 34, datë 27.05.2025; nr. 25, datë 23.04.2025 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjykata ka theksuar gjithashtu se e drejta e pronës, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, përfshin çdo posedim të sendeve pronësia e të cilave është fituar në përputhje me ligjin (*shih vendimet nr. 31, datë 18.04.2024; nr. 53, datë 31.10.2023; nr. 36, datë 21.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*), përfshirë edhe përmes vendimeve *quasi* gjyqësore të organeve të kthimit dhe kompensimit të pronës. Sipas Gjykatës, vendimet e paankimuar të këtyre organeve konsiderohen të formës së prerë dhe të ekzekutueshme, ndaj ato nuk mund

të vihen në diskutim as nga palët në proces, as nga organet shtetërore të çfarëdo natyre qofshin (*shih vendimin nr. 27, datë 26.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, neni 41 i Kushtetutës nuk ka përcaktuar kriteret që duhen zbatuar për përcaktimin e “shpërblimit të drejtë” të pronës, që do të thotë se kushtetutëbërësi e ka lënë në diskrecionin e ligjvënësit për të përcaktuar treguesit konkretë të vlerësimit të saj (*shih vendimet nr. 82, datë 18.12.2025; nr. 33, datë 30.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Ligji i Pronave, me përmbajtje të njëjtë si në momentin e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit, ashtu edhe aktualisht, ka përcaktuar rregullat e kompensimit të ish-pronarëve të shpronësuar (*neni 6*), duke parashikuar se prona e njohur për kompensim vlerësohet në bazë të zërit kadastral që ka pasur në kohën e shpronësimit (*pika 1, shkronja “a”*). Kjo dispozitë nuk ka pësuar ndryshime, pavarësisht ndryshimeve që ka pësuar Ligji i Pronave bazuar në vendimmarrjet nr. 1, datë 16.01.2017 dhe nr. 4, datë 15.02.2021 të Gjykatës. Po sipas këtij ligji, “truall” është toka që ndodhet brenda vijave kufizuese të qyteteve e qendrave të banuara në çastin e shpronësimit. Kur për qendrën e banuar nuk ka pasur vijë kufizuese, truall do të jetë sipërfaqja e tokës që zë objekti i ndërtuar mbi të dhe oborri funksional. Sipërfaqja e këtij të fundit llogaritet sa trefishi i sipërfaqes së objektit, por jo më shumë se 500 m². Ndërsa “tokë bujqësore” është toka që ndodhet jashtë vijave kufizuese të qyteteve e qendrave të banuara në çastin e shpronësimit dhe që si e tillë figuron në regjistrat kadastralë të shtetit, e zënë me bimët e arave, pemishtet, vreshtat dhe ullishtat, kudo ku ndodhet dhe që ka veçori thelbësore të saj pjellorinë (*neni 5, pikat 12 dhe 13*).

26. Ndërsa VKM-ja nr. 223, datë 23.03.2016 (*VKM nr. 223/2016*), sipas përmbajtjes në fuqi në kohën e gjykimit të çështjes nga gjykata e apelit, ka përcaktuar se zëri kadastral i origjinës së pronës përcaktohet duke u bazuar në dokumentacionin ligjor të administruar në dosje. Në mungesë të këtij të fundit, për përcaktimin e zërit kadastral përdoret harta e kohës së shpronësimit dhe, në mungesë të saj, harta që është më e afërt me kohën e shpronësimit. Në pamundësi objektive për përcaktimin e zërit kadastral, sipas kësaj shkronje, atëherë vendimi i kompensimit vlerësohet financiarisht me çmimin minimal të përcaktuar në hartën e vlerës për atë njësi administrative dhe për atë kategori prone (*pika 3, shkronja “d”*). ATP-ja, për efekt të kompensimit dhe të ekzekutimit të vendimeve përfundimtare, vlerëson financiarisht vendimet, duke u bazuar në vlerat e përcaktuara në hartën e vlerës, dhe në rastet kur në hartën e vlerës mungon vlera e caktuar për zërin kadastral të origjinës, vlerësimi financiar i vendimit përfundimtar që ka njohur të drejtën e kompensimit bëhet duke u marrë si referim vlera me të njëjtin zë kadastral që ndodhet më afër pronës që do të kompensohet.

Në rast se pranë pronës që do të kompensohet gjenden disa zëra kadastralë të njëjtë me atë të origjinës së pronës, me distancë të njëjtë dhe me vlera të ndryshme, atëherë për referim në përlllogaritje merret zona që ka çmimin më të lartë (*pika 3, shkronja "dh"*). Kurse VKM-ja nr. 89/2016 ka përcaktuar vetëm vlerën e tokës "truall" në masën 1.587 lekë/m².

27. Në këndvështrim të standardeve dhe parashikimeve të mësipërme, Kolegji do të analizojë në vijim nëse, në kuadër të vlerësimit financiar të pronës, gjykatat e zakonshme kanë marrë në shqyrtim pretendimet e kërkueses për regjimin juridik të pronës në momentin e shpronësimit, si dhe nëse u kanë dhënë atyre përgjigje përfundimtare e të arsyetuar, në garantim të së drejtës së saj për akses substancial në lidhje me pretendimet për të drejtën e pronës.

28. Në rastin konkret, Kolegji vëren se nga materialet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të shqyrtimit paraprak të çështjes rezulton se prona objekt gjykimi është shpronësuar për qëllime shtetëzimi në vitin 1947 me dekretin nr. 331 të Presidiumit të Kuvendit Popullor, ku në nenin 3 të tij pasuria me sipërfaqe 7.000 m² e trashëgimlënësit Skënder Godo është referuar si "tokë", ndërsa pasuritë e subjektit tjetër të shpronësuar sipas të njëjtit nen janë identifikuar si "shtëpi" dhe "truall". Nga ana tjetër, me vendimin e saktësuar të vitit 1997, KKKP-ja, Delvinë i ka njohur trashëgimlënësit të kërkueses të drejtën e pronësisë mbi një sipërfaqe 7.000 m² "truall". Në këtë situatë, për përcaktimin e regjimit juridik të pronës për qëllime vlerësimi financiar, ATP-ja i është referuar hartës së Institutit të Gjeografisë dhe Infrastrukturës të vitit 1941 dhe dokumentacionit arkivor të vendimit nr. 294/1997 të KKKP-së, Delvinë, nga të cilët ka rezultuar sa ajo ka qenë pjesërisht "truall" dhe pjesërisht "tokë bujqësore". Në këto kushte, ATP-ja ka përcaktuar vlerën financiare të pronës duke marrë në konsideratë këta zëra kadastralë.

29. Kërkuësja ka kundërshtuar në Gjykatën Administrative të Apelit vlerën financiare të përcaktuar për pronën nga ATP-ja, duke parashtruar si shkak se prona kishte qenë një e tërë, ajo ishte ndarë nga shtetëzimi në vitin 1947 për 7.000 m² dhe, si e tillë, nuk mund të ishte pjesë e një vlerësimi me zëra të ndryshëm kadastralë. Gjykata ka rrëzuar pretendimet e saj, me argumentin se akti i shpronësimit i vitit 1947 nuk përcaktonte regjimin juridik/zërin kadastral të pronës në atë moment, ndërsa vendimi i KKKP-së, Delvinë, që e kompensonte për sipërfaqen 7.000 m² "truall", nuk përbën akt shpronësimi për qëllime të zbatimit të nenit 6, pika 1, shkronja "a", të Ligjit të Pronave. Po kështu, referuar dokumenteve hartografike të paraqitura nga eksperti, për sipërfaqen e objektit brenda konturit të saj, prona vlerësohej financiarisht sipas çmimit të përcaktuar nga VKM-ja nr. 89/2016 për zërin kadastral "truall". Ndërsa, në kushtet kur pjesa tjetër e pronës ndodhej jashtë konturit të vijës së verdhë të qytetit

të vitit 1965, vlera e saj financiare do të llogaritej sipas parashikimeve të pikës 3, shkronja “dh”, të VKM-së nr. 223/2016 për “tokën bujqësore” në zonën më të afërt gjeografikisht. Vendimi i gjykatës së apelit është gjetur i drejtë në vijim nga Gjykata e Lartë, e cila ka vlerësuar se rekursi i kërkueses nuk përmbante asnjë prej shkaqeve të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012 që mund të cenonin ligjshmërinë e vendimit të asaj gjykate.

30. Në analizë të vendimmarrjeve të mësipërme, përkundrejt rrethanave të çështjes e legjislacionit të zbatueshëm, Kolegji vëren se, në kundërshtim nga sa kërkuësja pretendon, gjykata e apelit ka dhënë përgjigje të arsyetuar për pretendimet e saj lidhur me zërin kadastral të pronës në çastin e shpronësimit, konkretisht se akti i shpronësimit nuk përmbante përcaktime në këtë drejtim, ndërsa vendimi i KKKP-së, Delvinë nuk përmbante akt shpronësimi për qëllime të Ligjit të Pronave. Po kështu, kjo gjykatë ka arsyetuar vendimmarrjen e saj edhe për sa i përket mënyrës së përlllogaritjes së vlerës financiare të pronës. Nga ana tjetër, Kolegji çmon se arsyetimi i kufizuar i Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit është në përputhje me standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor, sipas jurisprudencës kushtetuese, për sa kohë që ka pasqyruar pretendimet e parashtruara nga kërkuësja në rekurs dhe është shprehur mbi shkaqet e mospranimit të tij në kuadër të shqyrtimit paraprak në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në vlerësimin e Kolegjit, vendimmarrjet e kundërshtuara nuk rezultojnë arbitrare në këndvështrimin kushtetues ose të tilla që të kenë çuar në cenimin e së drejtës së kërkueses për pronën. Në këtë drejtim Kolegji vëren, gjithashtu, se masa e kompensimit të akorduar tejkalon kufirin prej 10% të vlerës së pronës, sipas zërit aktual kadastral, standard ky i njohur nga jurisprudenca kushtetuese si “shpërblim i drejtë” (*shih vendimet nr. 5, datë 13.02.2024; nr. 4, datë 15.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*), edhe nëse vlerësimi financiar do të ishte kryer duke përdorur si referencë zërin kadastral “truall”.

31. Për sa më lart, Kolegji konkludon se pretendimet e kërkueses për cenimin e së drejtës për akses substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe të drejtën e pronës janë haptazi të pabazuara.

32. Në përfundim, Kolegji çmon kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.